

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti për Krime të Rënda, Trupi gjykues i përberë nga Beqir Halili-Ktyetar i trupit gjykues dhe gjyqtareve Sabit Rama dhe Florije Sylja-Anetar të trupit gjykues, me procesmbajtësen Femije Kyqyku, në lëndën penale kundër të pandehurit [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 pika 1.2 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore-Departamenti për Krime të Rënda-Mitrovicë PPI.nr.385/2015 të datës 05.07.2017, të cilën e përfaqëson Prokurori Njazi Rexha, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datën 20.12.2017, në prezencën e të pandehurit [REDAKTUAR] e në mungesë të prokurorit Njazi Rexha, të njëjtën ditë edhe shpalli, ndërsa me datën **28.12.2017**, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

[REDAKTUAR], me nofkën "[REDAKTUAR]" i biri i [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR] i lindur me 17.13.1974 në fshatin [REDAKTUAR] komuna e [REDAKTUAR], e me vendbanim në [REDAKTUAR] në rrugën "[REDAKTUAR]", me numër personal [REDAKTUAR], shqiptar, kosovar, i pa punë, i martuar, baba i një fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, me parë o pa gjykuar, ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedure tjetër për vepër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE:

Me datën 8 Qershor 2014, në shkollën "SH.M.U.1" në Vushtrri, në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, në vendvotimin numër [REDAKTUAR] ka votuar si votues i me kusht edhe pse me parë ka votuar si votues i rregullt.

- Me këtë ka kryer veprën penale **Keqpërdorimi i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 pika 1.2 të KPRK-së.**

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 41, 45, 51, 73, 74 të KPRK-së, dhe nenit 365, 366, dhe 450 par 2.6 të KPP-së, e:

GJYKON

ME DËNIM ME BURG, në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili nuk do të ekzekutohet në periudhën kohore prej një (1) viti, me kushte që i pandehuri të mos kryejë veprë të re penale.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale e në emër të paushallit gjyqësor ta paguaj shumën prej pesëdhjete (50) Euro.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së formës së prere të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Kërkesa pasurore juridike nuk ka pasur.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë PPI.nr.385/2015 të datës 05.07.2017, kundër të pandehurit [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 pika 1.2 të KPRK-së

Gjatë shqyrtimit gjyqësor i pandehuri [REDAKTUAR] e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale për të cilën ngarkohet.

Prokurori i shtetit Njazi Rexha në fjalën përfundimtare deklaroi: Nuk është kontestuese se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet në aktakuzë, e që vërtetohet nga vet pranimi i fajësisë nga vet i pandehuri dhe nga raporti i ekspertizës nga i cili rezulton se në bazë të rezultatit të ekspertimit konstatohet se nënshkrimet në dokumentet e evidentuara, në dëshmitë D1, D2 dhe D3 dhe nënshkrimet mostra të njohura të evidentuara në dëshmitë D4 dhe D5 janë të shkruara nga i njëjti person, andaj i propozoj Gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor për veprën e kryer penale, e me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit t'i ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese.

I pandehuri [REDAKTUAR] në fjalën përfundimtare deklaroi: Se e pranoj fajësinë dhe e lus Gjykatën që të ma shqipton një dënim sa ma të butë.

Trupit gjykues përcakton se i akuzuari e kuptoj natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë se me pranimin e fajësisë nuk do të mbahet shqyrtimi gjyqësor, nuk do të ketë të drejtë të propozoj prova si dhe të paraqes ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike. Pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga ana e të akzuarit, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori.

Me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata si rrethana lehtësuese në vështrim të nenit 74 par. 3 nënpar. 3.3, 3.8, 3.10 e 3.11 të KPRK-së, i ka marrë se: i akuzuari për herë të parë ka rënë në kundërshtim me ligjin pasi që nuk është i dënuar me aktgjykim të formës së prerë, ka bashkëpunuar në mënyrë korrekte me gjykatën dhe organet e ndjekjes, i akuzuari e ka pranuar fajësinë, ka shfaqur keqardhje për veprën e kryer penale, është penduar se e ka kryer këtë veprë dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale.

Gjykata të akuzuarit i ka shqiptuar dënim e parashikuar me ligj pasi që për veprën penale Keqpërdorimi i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 pika 1.2 të KPRK-së, parashihet dënimi prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 51 par.1 dhe 2 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili nuk do të ekzekutohet në periudhën kohore prej një (1) viti, me kusht që i pandehuri të mos kryej vepër të re penale.


Duke marr parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 par. 1 të KPRK-së, që ti parandaloj kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor.

Në bazë të të dhënave të shënuara si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti për Krime të Rënda
P.nr.94/2017, me datën 28.12.2017

Kryetari i trupit gjykues
Beqir Halili



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh Gjykatës se Apelit në Prishtinë-Departamentit për Krime të Rënda, e përmes kësaj Gjykate.